



Pranuar / Dorezuar Prilideno/Prudato Received/Delivary	11.03.2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojt e Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKANDINAVIA	1313/2022		1/3

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.Nr.68/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Malore Gashi-Bajraktari kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani - anëtarë, me Zyle Millaku Gojnovci- Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit për shqyrtimin e ankesës së datës 27.01.2022 me numër rendor A.Nr.68/2022, të parashtruar nga ankuesit dhe kundër Vendimit Nr.protokolli 16/2022 të datës 25.01.2022 të Sekretarit të Përgjithshëm në Institucionin e Avokatit të Popullit, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nen paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në seancën për këshillim dhe votim me datë 11.03.2022, mori këtë

V E N D I M

PËRFUNDON procedimi administrativ i iniciuar me ankesën me numer A.nr.68/2022 të datës 27.01.2022 të parashtruar nga ankuesit dhe

A r s y e t i m

Ankuesit i punësuar në Institucionin e Avokatit të Popullit-IAP-së, sipas Ndryshim dhe Plotësim të Akt emërimit të datës 29.01.2018 në pozitën "Udhëheqës i Divizionit të Teknologjisë Informative", dhe Besian Gashi në pozitën "Zyrtar i Teknologjisë Informative" me datë 27.01.2022 kane parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokoli 16/2022, të datë 25.01.2022 të Sekretarit të Përgjithshëm në Institucionin e Avokatit të Popullit, për formimin e komisionit për monitorimin e implementimit të punëve të investimeve të projektit kapital të TI nga ana e operatorit ekonomik i kontraktuar nga BE.

Me datë 25.02.2022, Sekretari i Përgjithshëm në Institucionin e Avokatit të Popullit, ka nxjerrë Vendimin me numër protokoli 55/2022, me të cilin ka anuluar Vendimin me numër protokoli

16/2022 të datës 25.01.2022, të kundërshtuar nga ankuesit, duke vlerësuar se është në dobi të të gjitha paleve bazuar në Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 21.02.2022 ka përcjell kërkesën për përgjigje në ankesë, tek Institucioni i Avokatit të Popullit-IAP-së, i cili me datë 25.02.2022, e ka përcjellë përgjigjen në ankesë në formë elektronike e cila është protokolluar me nr. 1013/2022 me shkresat e bashkangjitura prej 1/7 faqe.

Administrimi i Provave, Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën A. Nr.68/2022 e parashtruar më datë 27.01.2022 me numër protokoll 266/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shënimin Civil të Kosovës; Vendimi Nr.protokoll 16/2022 të datës 25.01.2022 i Sekretarit të Përgjithshëm në Institucionin e Avokatit të Popullit-IAP-së; Përgjigjen në ankesë e datë 25.02.2022 (në formë elektronike E-maili) e cila është protokolluar me nr. 1013/2022; Ndryshim dhe Plotësimi i Akte emërimit i datës 29.01.2018, me Përshkrim të detyrave të punës; Vendimi me nr.protokoll 55/2022 i datës 25.02.2022 i Sekretarit të Përgjithshëm në Institucionin e Avokatit të Popullit-IAP-së.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës ka konstatuar se objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ me ankesën e ankuesit *është bërë i pamundur, sepse,*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueseve lidhur me caktimin e tyre si anetar në Komisionin për monitorimin e implementimit të punëve të investimeve të projektit kapital të TI nga ana e operatorit ekonomik i kontraktuar nga BE sipas Vendimit me numer protokoll 16/2022 të datës 25.01.2022 të nxjerre nga Sekretari i Përgjithshëm në Institucionin e Avokatit të Popullit, gjegjesisht ankuesit pretendojnë se ky vendim është nxjerre në kundërshtim me legjislacioni në fuqi.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar deshmët e ofruara nga ankuesi dhe organi i punesimit ka konststuar se Sekretari i Përgjithshëm në Institucionin e Avokatit të Popullit duke u bazuar në nenin 21 të Rregullores së Punës Nr.02/2016 së Institucionit të Avokatit të Popullit me datë 25.01.2022, ka nxjerrë Vendim me numer protokoll 16/2022, me të cilin ka themeluar Komisionin për monitorimin e implementimit të punëve të investimeve të projektit kapital të TI nga ana e operatorit ekonomik i kontraktuar nga BE dhe permes ketij vendimi ka caktuar si anetar të këtij komisioni ankuesit, ndwrsa Institucioni i Avokatit të Popullit konkretisht Zyra e Personelit me datë 25.02.2022, permes pergjigjjes ne ankese e ka njoftuar Këshillin e Pavarur Mbikeqyres të Kosoves se Sekretari i Përgjithshëm në Institucionin e Avokatit të Popullit me Vendimin me numër protokoll 55/2022, të datës 25.02.2022 e ka anuluar Vendim me numër protokoll 16/2022 të datës 25.01.2022.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, duke marr parasysh faktin se me nxjerrjen e Vendimit me numer protokoll 55/2022 të datës 25.02.2022 nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm në Institucionin e Avokatit të Popullit është anuluar Vendimi me numer protokoll 16/2022 i datës 25.01.2022 konstaton se pretendimet e ankuesve janë përmbushur apo realizuar sepse edhe ankuesit kanë pretenduar anulimin e këtij Vendimi, kështu që objekti për të cilin kishte filluar procedimi

administrativ me ankesën e ankuesve është përmbushur dhe mbi këtë bazë nuk ka më objekt shqyrtimi pasi që objekti i lëndës është bërë i pamundur, ashtu siç përcaktohet me dispozitat e nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku theksohet se: *“Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë”*, andaj Kolegji ne rastin konkret konstaton se janë plotësuar kushtet për përfundimin e procedimit administrativ të iniciuar me ankesën e datës 27.01.2022 të parashtruar nga ankuesit dhe

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Iniciimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda A.Nr.68/2022.

Zyle Millaku GOJNOVCI

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



Malsore GASHI BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm në Institucionin e Avokatit të Popullit-IAP-së,
- Udhëheqësit të Personelit në Institucionin e Avokatit të Popullit-IAP-së dhe,
- Arkivit të KPMSHCK-së .

